



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1231 Prot.

Tiranë, më 06. 08. 2019

V E N D I M

Nr. 105, Datë 06. 08. 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 59, datë 29.05.2019, e shtetases V. R., në cilësinë e kujdestares ligjore e vajzës së saj B. Gj., kundër Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, me pretendimin diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja sqaron se vajza e saj B. Gj., aktualisht është e ndaluar në mjediset e Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (në vijim IVSHB). Sipas ankueses, vajza e saj është e diagnostikuar me Skizofreni që prej vitit 2002. Që nga datë 24.11.2017, ajo është vendosur në mjediset e IVSHB-së Tiranë, ku vijon të marrë trajtimin mjekësor, referuar vlerësimit të Komisionit Mjeko Ligjor. Sipas ankueses, vajza e saj është keqtrajtuar dhe vijon të keqtrajtohet nga personeli i Policisë së Burgjeve, duke rënduar kështu gjendjen e saj shëndetësore.

Në përfundim, ankuesja pretendon se vajza e saj trajtohet në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese për shkak të gjendjes së saj shëndetësore nga ana e personelit të Policisë së Burgjeve. Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të rekomandojë transferimin e saj në një mjedis spitalor të specializuar për diagnozën e saj, në mënyrë që të ketë rezultate në përmirësimin shëndetësor.

¹ Mbështetur në Vendimin Nr. xxxx të Drejtorisë Rajonale të Shëbimit Social Shtetëror Tiranë, B. Gj. është e diagnostikuar me Skizofreni, tipi Bipolar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Përsa më lart, me anë të shkresës Nr. 827/1 prot., datë 07.06.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjektit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, ku i ka kërkuar informacion dhe parashtrime rreth ankesës së paraqitur nga ana e V. R.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën³ Nr. 5249/1 prot., datë 13.06.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ndër të tjera sqaroi se: *“...shtetësja B. Gj., e datëlindjes 26.06.1995, lindur në Tiranë, është akomoduar në Qendrën Spitalore të Burgjeve, me datë 26.11.2017, me vendim Gjykate⁴, me masë mjekësore ‘Shtrim i përkohshëm’. Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetësja B. Gj., që në momentin e pranimit në Spital është konsultuar me mjeken psikiatre dhe i është ofruar kujdes shëndetësor e psiko-social. Mbi bazë të këtyre*

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

³ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 827/2 prot., datë 19.06.2019

⁴ Vendimi Nr. xxxx, datë 26.11.2017 Gjykata Tiranë, Neni 121/a, 89 të Kodit Penal, “Përndjekje”, “Plagosje e lehtë me dashje”.

konsultave, mjekët specialistë psikiatër kanë rekomanduar trajtimin përkatës me medikamente, të cilat janë siguruar nga institucioni⁵. Që në momentin e hospitalizimit dhe në vazhdimësi kjo paciente është ndjekur në dinamikë dhe i është nënshtruar ekzaminimeve mjekësore⁶, konsultave me mjekët specialistë dhe po trajtohet në spital sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë. Më datë 11.06.2019, i realizohet konsultë e përgjithshme me mjekët specialist, ku rezulton: ‘në momentin e konsultës, pacientja flet pa pushim, herë qesh, herë qan, referon se e merr malli për familjen, pacientja pyet nëse ndonjë moment është ndier e keqtrajtuar apo e dhunuar nga stafi punonjës i spitalit-ajo referon se i gjithë stafi sillet shumë mirë me të’. Në inspektimin mjekësor nuk evidentohet asnjë shenjë dhune apo përdorimi force. Gjithashtu, nga ana e V. R. nuk ka asnjë ankesë apo shqetësim për këtë çështje, drejtuar stafit të punonjësve apo titullarit të institucionit. Siç shihet nga verifikimet e dokumentacionit shëndetësor, pacientja B. Gj. është ndjekur në vazhdimësi e në dinamikë, i është ofruar kujdesi shëndetësor, psiko social dhe është trajtuar sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë. Së treti, evidentojmë se referuar informacionit të stafit të policisë së institucionit dhe dokumentacionit, shtetësja B. Gj. gjatë qëndrimit në spital nuk është diskriminuar apo keqtrajtuar nga stafi i policisë, ajo ka ndjekur aktivitetin ditor dhe gëzon të gjitha të drejtat sipas akteve ligjore. Në mënyrë të vazhdueshme i është ofruar asistencë psikologjike në trajtimin e saj psiko-emocional është punuar me terapi të ndryshme⁷. Përsa i përket shqetësimit të ngritur nga familjari i saj për diskriminim apo keqtrajtim, evidentojmë se asesi nuk ndodh në Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale e as nuk mund të ndodh në Spitalin e Burgut për pacientë të hospitalizuar. Nëse i referohemi dhe raportit paraprak të përcjellë nga Komiteti i Parandalimit të Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT) të Këshillit të Evropës në lidhje me vizitën monitoruese të kryer gjatë periudhës 20-30 nëntor 2018, nuk konstatohet prej tyre asnjë rast apo ankesë e të burgosurve për diskriminim apo keqtrajtim. Ky konstatim nuk rezulton në monitorimet e kryera nga institucioni i Avokatit të Popullit. Së fundmi shtetësja B. Gj. ndiqet në dinamikë nga mjekët, trajtohet sipas rekomandimeve të mjekëve specialist dhe mbahet nën mbikqyrje të vazhdueshme nga stafi shëndetësor dhe psiko-social i Spitalit të Burgut”.

- Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 126, datë 19.07.2019 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, Tiranë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e shtetases V. R.”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë subjektit IVSHB Tiranë, më datë 26.07.2019, për të marrë informacion dhe për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit të kryer, inspektorët e KMD-së morën takim me përfaqësuesit e IVSHB-së, A. L., me detyrë Drejtor i IVSHB-së dhe shtetasen E. Q., me detyrë Mjeko Psikiatër e këtij

⁵ Kjo shtetase është diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor Dg: çrregullim afektiv bipolar dhe trajtohet me terapi anti psikotik-

⁶ Ekzaminime mjekësore, konsulta me mjekët specialist janë të evidentuara në kartelën klinike nr. xxx, datë 26.11.2017.

⁷ Nga ana e stafit psiko-social i është ofruar terapi këshillimi individuale dhe në grup, terapi okupacionale, veprimtari kreative dhe sociale.

institucionit. Sipas përfaqësuesve të IVSHB-së, B. Gj. i është nënshtruar vizitave vazhdimisht, përpara dhe pas marrjes së ankesës nga KMD dhe nga ana e saj nuk është shprehur asnjëherë ndonjë shqetësim lidhur me trajtimin e saj nga stafi i institucionit, si dhe nuk është evidentuar se ndaj saj ka patur ushtrim dhune. Sektori në të cilin është e vendosur B. Gj., janë të hospitalizuara vetëm zonja të cilat kanë probleme të shëndetit mendor, në këtë kuptim, sipas përfaqësuesve të IVSHB-së, nuk qëndron shkak i diskriminimit të gjendjes shëndetësore. Gjithsesi nga ana e grupit të inspektimit u konsultua kartela mjekësore e B. Gj., në të cilën nuk evidentohet asnjë ankesë apo informacion i referuar prej saj, lidhur me keqtrajtimin e saj nga stafi i institucionit. Gjithashtu, u konstatua se B. Gj. i janë kryer të gjitha ekzaminimet mjekësore të rekomanduara nga mjekët specialistë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Nga kqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, me Vendim Nr. 2698, datë 26.11.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe për shkak të gjendjes shëndetësore të saj, është e akomoduar në IVSHB Tiranë. Mbështetur në Kartelën Mjekësore Nr. 445, datë 26.11.2017, B. Gj. në momentin e pranimit në IVSHB është konsultuar me mjekët specialist dhe mjeken psikiatre, i është ofruar kujdes shëndetësor e psiko-social, si dhe është trajtuar në vazhdimësi me medikamente të siguruara nga IVSHB. Pas ankesës së depozituar pranë KMD-së, konstatohet se më datë 11.06.2019, B. Gj. i është nënshtruar një konsulte të përgjithshme me mjekët specialist dhe ka rezultuar se në momentin e konsultës, ajo nuk ka paraqitur asnjë ankesë ndaj stafit të IVSHB-së, si dhe nga mjekët specialist nuk janë evidentuar shenja dhune apo përdorimi force.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.* Neni 18, i saj shpreh se *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”.* Neni 25, përcakton se: *“Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti”.*

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore⁸ (KEDNJ), është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, Ndalimi i diskriminimit, përcakton se : *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Neni 33 i ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe trajtimin e të dënuarve”, i ndryshuar, sanksionon se: *“Shërbimi mjekësor i sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve. Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve”*.

Gjithashtu në nenin 33/1 të ligjit të sipërcituar, ndër të tjera parashikon se: *“...Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor mbështetet në ligjin për shëndetin mendor. Të dënuarit dhe të paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë seksioneve mjekësore të posaçme të institucioneve ose në qendrën spitalore të burgjeve...Trajtimi shëndetësor i grave të dënuara dhe të paraburgosura përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor si: praninë e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme ose sëmundjeve të lindura të gjakut; nevojat për kujdesin shëndetësor mendor, përfshirë trajtimet e çrregullimeve posttraumatike, të rrezikut të vetëvrasjes ose vetëdëmtimit; historinë e shëndetit riprodhues; praninë e varësisë të drogës; abuzimin seksual dhe forma të tjera të dhunës që mund të ketë pësuar përpara pranimit në institucion...”*

Mbështetur në informacionin e gjendur në Kartelën Mjekësore Nr. 445, datë 26.11.2017, B. Gj. në momentin e akomodimit në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve Tiranë, pas konsultave me mjekët specialist dhe mjeken psikiatre, i është siguruar trajtimi shëndetësor e psiko-social, si dhe në vazhdimësi trajtimi me medikamente të siguruar nga IVSHB. Në këtë kuptim dhe në referim të legjisllacionit të sipërcituar, administrata e Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve Tiranë, i ka siguruar ankueses medikamentet dhe trajtimin e nevojshëm mjekësor në raport me gjendjen e saj shëndetësore.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjisllacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjitha institucionet.

⁸ Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së⁹. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në ky Ligj, ka parashikuar në nenin 7/1: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Nga analiza legjislativitetit dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Institucioni i Veçantë Shëndetësor të Burgjeve nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të. Gjithashtu, referuar provave të administruara nuk konstatohet se ndaj ankueses të jetë përdorur dhunë apo të jetë keqtrajtuar nga ana e stafit të IVSHB-së.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e stafit të Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, Tiranë, për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁹ Referuar nenit 3, pika 8 ,e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases B. Gj. nga ana e Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, Tiranë, për shkak të “gjendjes shëndetësore”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

(Shkaku: Gjendja shëndetësore)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)